

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Hansi Flick dhe fjalët e Yamal për Topin e Artë: Do të doja të mos e kishte thënë, por... Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/hansi-flick-dhe-fjalet-e-yamal-per-topin-e-arte-do-te-do-ja-te-mos-e-kishte-thene-por/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:15:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:13:37 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4a9431d316f4b6da88b59a43442525843633cce1245d81309dfd5ccc9feef97f
TEKSTI	24510b7571c9d32710949bf70ead38232caa899f3c3e349c6d1f26a198e33eff
PAMJA	c19b716c0a2bb5a6ae298e63479347f83590378201b85aa2457303c812f11c8b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	104c98d47cf1c672cdea44620f1ea6c98bdcdbf1a34e5b26fa77534b5ac4487d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/104c98d47cf1c672cdea44620f1ea6c98bdcdbf1a34e5b26fa77534b5ac4487d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Sport

Hansi Flick dhe fjalët e Yamal për Topin e Artë: Do të doja të mos e kishte thënë, por...



Armelda Methasani

15 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Trajneri i Barcelonës, **Hansi Flick** këtë të martë u shfaq përpara medias në një konferencë për shtyp në prag të ndeshjes me Racing Santander.

Trajneri gjerman foli për një sërë temash duke nisur nga ajo për pauzën e ndeshjeve të kombëtareve që tashmë po afron dhe për faktin që mund të ketë dëmtime të mundshme lojtarësh.

‘Nuk mund të ndryshoj dot asgjë-tha Flick-më parë kishte 3 pauza të kampionatit për kombëtarët, tani janë 2 dhe njëra prej tyre është më e gjatë. Për klubet nuk është situata më e mirë, por është vendosur kalendari që është dhe nuk kam se çfarë të them më shumë’.

Padyshim që Flick foli edhe për faktin që Camp Nou do të presë finalen e Ligës së Kampioneve në 2029 duke e cilësuar si një lajm të mirë për Barcelonën

‘Është ëndrra jonë padyshim dhe është një lajm i mirë për klubin. Është diçka impresionuese që Camp Nou do të jetë stadiumi i finales-vijoi trajneri gjerman-a do të jem në finalen e 2029? Do të jem si trajner...apo si tifoz i Barcelonës. Në futboll nuk i dihet asnjëherë. Tani po argëtohem, ky klub dhe kjo skuadër janë fantastike, por asnjëherë nuk i dihet...’

Prej ditësh kanë nisur debatet për Topin e Artë dhe tashmë futbollistët kanë nisur fushatën. Lamine Yamal e ka bërë diçka të tillë teksa tha se e meriton ta fitojë këtë trofe.

‘Nuk është e lehtë. Unë flas vetëm për Lamine, jo për futbollistët e tjerë-tha Flick-është i sinqertë dhe më duket diçka e mirë që ka kaq shumë vetëbesim. Por do të preferoja që të mos fliste kështu, por për lojtarët është i rëndësishëm Topi i Artë. Është i sinqertë, është ndjesia e tij dhe unë padyshim e mbështes’

Flick foli edhe për zhurmën rreth këtij trofeut dhe për faktin se tashmë klubi i Barcelonës po e bën fushatën në Yamal

'Kjo situatë gjithnjë ka qenë kështu-shtoi Flick-në këtë moment nuk mund të fitosh tituj, por vetëm ndeshje. Duhet të punosh shumë për të marrë rezultate. Për mua më të rëndësishëm janë titujt kolektivë, por janë edhe ata individualë dhe për këtë duhet të punosh shumë. A ka fushatë për Lamine Yamal? Përse të mos e bëjmë, është futbollisti ynë. Po luan mirë dhe kjo është situata. Jam dakord me këtë. Kur i sheh lojtarët të stërviten, mund të kuptosh që i mbështesim'.

LAJME TË NGJASHME



Barcelona dhuron sërish spektakël, mund Levanten dhe ruan me pikë të plota kreun e La Ligës

1 MIN



Yamal dhe 'Topi i Artë': Nuk do të lutem të ma japin, objektivi kryesor, Champions League

1 MIN



Nga Kane e Yamal te Rodri dhe Messi, publikohet lista me 30 kandidatët për Topin e Artë 2026/ Shumë emra surprizë, por mungon Raphinha

5 MIN



Topi i Artë 2026/ Kush do të pasojë Dembele dhe Bonmati? Ja kur do të mësohen emrat e finalistëve

1 MIN



Saviceviç: Turp që Baresi nuk fitoi "Topin e Artë"!

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Biletat për ndeshjet e Shqipërisë, edhe fizikisht pranë "Air Albania"-s!



Oasis nuk ndalen! Liam dhe Noel Gallagher rikthehen sërish në skenë me 38 koncerte?



Arresti i Erion Veliajt, sot çështja në Gjykatën e Lartë!



"Burri e tradhtonte me shokun e ngushtë..."/ Shkënda Lili habit me rastin: Kishte kapur disa foto intime në...



Rrëzohet kërkesa e Ilir Metës për lirim nga burgu!



Sydney Sweeney pozon nudo për reklamën e re dhe shpërthen



Kujtimet në Top Channel dhe dashuria për ekranin, "rikthehet" Albana Osmani: Do të doja të bashkëpunoja me Ledionin...



Për kë vazhdon të blejë lule te dyqani i motrës së Stelinës? Miri zihet ngushtë: Për atë...



Makina përplas 69-vjeçarën me biçikletë, ndërron jetë rrugës për Tiranë!



"E ëma e qëllloi me gur për ta vrrarë", Pastor Vilajeti rrëfen historinë e fëmijës që shpëtoi!

EDITORI SUGJERON



Sasia ideale e proteinave që duhet të hani në mëngjes, sipas një dietologu...



4 kardiologë tregojnë ushqimet që konsumojnë rregullisht për të ndihmuar në uljen e tensionit dhe...



7 ilaçe që mund të ndërveprojnë me çajin jeshil?!



Tom Holland bën histori në Hollywood, bëhet aktori me filmat më fitimprurës të të gjitha kohërave!



Pyetëm një dietolog nëse yndymat e kikirikëve janë të mira për zemrën?! Ja se çfarë tha...



"Seven Up!" i jep lamtumirën kamerës pas 62 vitesh, fëmijët që u filmuan në moshën 7-vjeçare festojnë 70-vjetorin!



Çfarë mund të ndodhë nëse hani avokado rregullisht?!



Cili është lloji më i mirë i drithërave për të ulur kolesterolin?!



Koha më e mirë për të ngrënë kumbulla të thata për tretje më të mirë!



7 mënyra të shëndetshme për t'i dhënë shije të ëmbël tërshërës...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontakti
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms